

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6365  
E premte, 16 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

## Konjufca mbështet hartimin e rregullores së re të Kuvendit



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)


facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE I KOSOVËS (IKShPK) KA DALË ME ANALIZA PËR HELMIMIN E MBI 1 300 QYTETARËVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

## GJENDEN BAKTERE NË UJIN E PIJSHËM TË DEÇANIT

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se nga mostrat e ujit, të marra në Deçan më 12 korrik, janë identifikuar disa baktere që mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm. Ky institut ka njoftuar se ekzaminimet mikrobiologjike në mostrat e pranuar nga pacientët me shenja të infeksionit janë duke vazhduar. IKShPK-ja, pas analizave, ka dhënë dhjetë rekomandime për ta menaxhuar këtë situatë



FLET PËR "EPOKËN E RE", BASHKIM RAMOSAJ

## REAGIMI I QEVERISË ISHTE SHUMË I VONUAR



Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se reagimi i qeverisë ndaj situatës në Deçan ka qenë shumë i vonuar. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria i ka dalë në ndihmë kësaj komune vetëm tri ditë pas paraqitjes së rasteve të para të helmimit. Ramosaj ka treguar se, pas analizave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, të cilat tregojnë shkaqet e helmimit të ujit, do të marrë masa ndaj kompanisë rajonale të ujësjellësit "Hidrodrini". Ai ka paralajmëruar se komuna do ta heqë këtë kompani nga menaxhimi i ujërave

## MBI 40 TË VDEKUR DHE DISA TË ZHDUKUR NGA PËRMBYTJET NË GJERMANI



### AKTUALE



### ARRESTOHEN DHJETË ZYRTARË KOMUNALË NË KOSOVË


### DISKUTOHET PËR DRAFTIN FILLESTAR TË PROJEKTLIGJIT PËR VERIFIKIMIN DHE KONFISKIMIN E PASURISË

### GËRVALLA VIZITON KOZ-NË, ARC-NË DHE AEROPORTIN E PRISHTINËS, INTERESOHET PËR SHËRBIMET E MËRGGATËS

### EKONOMI

### KRYETARI I BORDIT I ARKEP-it: ASNJË OPERATOR ILEGAL NUK OFRON SHËRBIME NË VEND

### PËRFAQËSUESIT E OAK-ut DISKUTOJNË ME ALIUN PËR PROBLEMET E BIZNESEVE



### SPORT

### VANGJELI: SHPRESOJ QË GJITHË PËRVOJËN TIME T'IA PËRCJELL PRISHTINËS

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepgjsh - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Mbi 40 të vdekur dhe disa të zhdukur nga përmbytjet në Gjermani



**BERLIN, 15 KORRIK** - Së paku 42 njerëz kanë humbur jetën dhe disa të tjerë mbeten të zhdukur pas përmbytjeve që përfshinë pjesën perëndimore të Gjermanisë.

Landet Rajnland Falc dhe Nordrajn Vesthalen janë më të

goditurat.

Së paku katër njerëz humbën jetën edhe në Belgjikën fqinje, ndërsa Holanda u godit rëndë, po ashtu. Përmbytjet vijnë pas reshjeve rekorde në disa pjesë të Evropës. Malu Dreyer, shefe e policisë në landin Rajnland Falc,

i përshkroi ato si "katastrofike". "Ka të vdekur, të zhdukur dhe shumë njerëz janë ende në rrezik. Të gjitha shërbimet tona të urgjencës janë në aksion 24 orë dhe po rrezikojnë edhe jetën e tyre", ka thënë ajo.

Kancelarja gjermane Angela

Merkel, e cila ndodhet për vizitë zyrtare në ShBA, ka thënë se është "e tronditur nga katastrofa".

Shkollat u mbyllën në pjesën perëndimore të Gjermanisë, ndërsa shumë lidhje të transportit u ndërpre. Policia

ka njoftuar se dy zjarrfikës humbën jetën gjatë operacionit të shpëtimit në landin Nordrajn Vesthalen. Njëri, 46 vjeç, ra në ujë duke tentuar të shpëtojë një burrë, ndërsa tjetri, 52 vjeç, vdiq gjatë operacionit dhe përballjes me stuhinë.



## Bushi: Tërheqja e trupave nga Afganistani, e gabuar



**UASHINGTON, 15 KORRIK** - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, George W. Bush, i cili mori vendimin për t'i dërguar trupat amerikane në Afganistan në vitin 2001 për të luftuar al-Kaidën pas sulmeve të 11 shtatorit, thotë se mendon se është e gabuar që trupat amerikane të tërhiqen tani ndërsa kryengritësit talebanë marrin kontrollin e një pjese gjithnjë e më të madhe të territorit në vend.

Bush, që nga largimi nga detyra më 2009, ka komentuar rrallë

për veprimet e tre presidentëve të mëpasshëm Barack Obama, Donald Trump dhe Joe Biden.

Por, pas vendimit të Bidenit për t'i tërhequr me shpejtësi forcat amerikane nga Afganistani, duke thënë se të gjitha trupat do të jenë kthyer deri në fund të gushtit, ish-presidenti Bush thotë se është i shqetësuar për trajtimin e grave dhe fëmijëve dhe të tjerëve që kanë mbështetur forcat e ShBA-së dhe të NATO-s nga talebanët nëse ata marrin pushtetin përsëri pasi forcat amerikane i

dëbuan dy dekada më parë. Në një intervistë të bërë publike të mërkurën, ish-presidenti Bush i tha radiotelevizionit gjerman "Deutsche Welle" se druhet se "gratë dhe vajzat afgane do të pësojnë pasoja të papërshkrueshme".

I pyetur nëse është gabim që Biden t'i tërheqë trupat nga Afganistani, Bush tha: "Unë mendoj se po, sepse mendoj se pasojat do të jenë tepër të rënda dhe kjo më trishton". Lufta në Afganistan është më e gjata e Amerikës.

## "Mastercard" nuk do të lëshojë më kartela në Indi

**NEW-DELHI, 15 KORRIK** - Banka Qendrore e Indisë ia ndaluar kompanisë "Mastercard" lëshimin e kartelave të reja për konsumatorët e brendshëm. Banka e Rezervave të Indisë ka akuzuar këtë kompani për shkelje të ligjeve për ruajtje të të dhënave. Banka ka thënë se "Mastercard" nuk ka vepruar në përputhje me rregullat, që u

kërkojnë rrjetëve të huaja për kartela të tilla, që t'i ruajnë të dhënat për pagesat indiane ekskluzivisht në Indi.

"Mastercard" nuk ka reaguar ende ndaj këtij vendimi.

Kjo kompani nuk do të mund të lëshojë asnjë lloj të kartelës në Indi nga 22 korriku.

Vendimi i Bankës së Rezervave nuk do të ketë ndonjë ndikim

te konsumatorët ekzistues të "Mastercard".

Vitin e kaluar, përmes "Mastercard" janë kryer 33 për qind të të gjitha pagesave në Indi, sipas një kompanie me bazë në Londër, PRPO, ka raportuar agjencia e lajmeve AFP.

Më herët gjatë këtij viti edhe kompanive "American

Express" dhe "Diners Club" u është bllokuar lëshimi i kartelave të reja për shkak të shkeljeve të ngjashme.

Kompanitë me bazë në Shtetet e Bashkuara kanë reaguar ashpër ndaj këtij vendimi, duke thënë se ai mund t'i rrisë shpenzimet e të bërit biznes në



Indi. Megjithatë, banka indiane nuk ka kthyer vendimin mbrapsht.

# Gërvalla viziton KQZ-në, ARC-në dhe Aeroportin e Prishtinës, interesohet për shërbimet e mërgatës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka filluar të enjten vizitat zyrtare në nivel qendror dhe lokal për t'u njoftuar nga afër me shërbimet dhe kapacitetet për t'u ofruar shërbime pjesëtarëve të mërgatës gjatë periudhës së verës. Gërvalla fillimisht ka zhvilluar një takim me drejtuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Gjatë këtij takimi ajo ka biseduar me kryetarin e KQZ-së, Kreshnik Radoniqi dhe kryeshefin ekzekutiv Burim Ahmetaj, lidhur me informimin e mërgatës rreth procedurave të votimit jashtë vendit. Në këtë drejtim ministrja Gërvalla ka theksuar gatishmërinë e MPJD-së për ta ndihmuar KQZ-në për shpërndarjen e materialeve informuese nëpërmjet konsullatave, por edhe organizatave të ndryshme në diasporë, në mënyrë që informacioni të shpërndahet në kohën e duhur te pjesëtarët e mërgatës.

Takimin e radhës ministrja Gërvalla e ka pasur në Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), ku pati rastin të shohë nga afër ofrimin e shërbimeve nga ana e këtij



institucioni në periudhën me fluks të lartë të punës.

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të ARC-së, Blerim Camaj, e ka njoftuar ministren Gërvalla me të gjithë hapat që ka ndërmarrë ky institucion në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për t'i përballuar kërkesat në rritje gjatë muajve të verës nga pjesëtarët e mërgatës që

vijnë edhe për t'u pajisur me dokumente.

Palët u pajtuan që duhet të shikohen opsione për ta rritur gamën e shërbimeve sa i përket çështjes së pajisjes me dokumente nëpërmjet konsullatave të Kosovës nëpërmjet botës.

Gjithashtu, shprehën gatishmëri për ta thelluar bashkëpunimin

institucional që të ofrohen shërbime të mira dhe të shpejta për pjesëtarët e diasporës këtë vit. Po ashtu, Gërvalla vizitë ka zhvilluar edhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ku është informuar për shërbimet dhe fluksin e fluturimeve nga diaspora gjatë sezonit të pushimeve.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe Ragip Bunjaku, ushtrues i drejtorit të Departamentit për Kufi, e kanë njoftuar ministren Gërvalla me planin dhe hapat që kanë ndërmarrë për të ofruar shërbime gjatë kësaj periudhe të vitit, kur numri i fluturimeve është shumë i madh.

## Konjufca mbështet hartimin e rregullores së re të Kuvendit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka marrë pjesë të enjten në punëtorinë për shqyrtimin e draft-rregullores të Kuvendit të Kosovës, të organizuar nga grupi punues. Në fjalën e tij të rastit, kryekuvendari Konjufca i dha

mbështetje të plotë hartimit të rregullores së re, duke theksuar nevojën e përmbylljes sa më të shpejtë të këtij procesi. Kreu i legjislavit ka theksuar rëndësinë që rregullorja e re t'i plotësojë kërkesat e Kuvendit dhe në këtë mënyrë ta lehtësojë funksionimin e punës brenda institucionit.

Rregullorja e Kuvendit përcakton rregullat për

organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, organeve të tij drejtuese dhe trupave të tij të punës, në ushtrimin e funksionit ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues. Po ashtu, Rregullorja përcakton edhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## Arrestohen dhjetë zyrtarë komunalë në Kosovë

PRISHTINË, 15 KORRI (ER)- Dhjetë zyrtarë komunalë u arrestuan të enjten në disa komuna të Kosovës, nën dyshimet për keqpërdorim të autoritetit zyrtar. Kyeprokurori në Prokurorinë Themelore në Pejë, Agim Kurmehaj gjatë një konference për media ka dhënë detaje rreth këtyre bastisjeve. "Sot kemi shkuar në bastisje në tri komuna: Pejë, Klinë, Istog. Me këtë rast

janë arrestuar dhjetë persona, zyrtarë, kryesisht drejtorë të Drejtoratit për Urbanizëm, dhe inspektorë me dyshimet fillestare për veprën penale: keqpërdorim i autoritetit apo pozitës zyrtare", ka thënë ai. Prokuroria Themelore në Pejë ka njoftuar se ka bazë të mjaftueshme për të vazhduar më tutje hetimet rreth këtij rasti. Po ashtu, Prokuroria në Pejë ka njoftuar se bastisjet po kryhen nga Policia e Kosovës

në Pejë, Klinë dhe Istog, pas dyshimeve se disa zyrtarë komunalë kanë keqpërdorur pozitën zyrtare lidhur me disa ndërtime të paligjshme. "Për këto veprime në terren janë angazhuar pesë prokurorë të shtetit nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë në koordinim me Njësitin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Pejë.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, BASHKIM RAMOSAJ

# Reagimi i qeverisë ishte shumë i vonuar

Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se reagimi i qeverisë ndaj situatës në Deçan ka qenë shumë i vonuar. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se qeveria i ka dalë në ndihmë kësaj komune vetëm tri ditë pas paraqitjes së rasteve të para të helmimit. Ramosaj ka treguar se pas analizave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, të cilat tregojnë shkaqet e helmimit të ujit, do të marrë masa ndaj kompanisë rajonale të ujësjellësit “Hidrodrini”. Ai ka paralajmëruar se komuna do ta heqë këtë kompani nga menaxhimi i ujërave

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për mosveprim të duhur në raport me situatën e helmimeve në këtë komunë. Ai ka thënë se veprimi i qeverisë ka qenë shumë i vonuar. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Ramosaj ka deklaruar se pas mbështetjes nga qeveria, menaxhimi i situatës ka qenë më i lehtë. “Veprimi i qeverisë ka qenë tepër i vonuar sepse, siç dihet, rastet e para të helmimit kanë ndodhur ditën e shtunë. Pra, për katër ditë si komunë jemi përballur krejtësisht të vetëm me menaxhimin e situatës, ndërsa reagimi i qeverisë ka ndodhur ditën e martë.

Fillimisht mbështetja e saj ka qenë deklarative, më pas edhe me veprime konkrete. Natyrisht se mbështetja na ka lehtësuar menaxhimin e situatës”, ka thënë Ramosaj.

Ai ka mirëpritur rezultatin e analizave të fundit nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) të cilat tregojnë se në mostrat e ujit të marra në Deçan më 12 korrik janë identifikuar disa baktere të cilat mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm.

Ramosaj ka thënë se si kryetar i komunës ka qenë këmbëngulës që të ketë një përgjigje shkencore për situatën. “Kjo përgjigje tani është marrë. E kemi parë si shqetësim kur ditën e hënë analizat kimike të ujit kanë dalë në rregull, pastaj ditën e martë analiza tjetër ka

treguar që në aspektin biologjik uji është i përdorshëm. Por, kur u bënë analizat më të thella, doli se nuk është krejt në rregull. IKShPK-ja ka dhënë edhe rekomandime se si duhet të veprohet”, është shprehur ai, duke treguar për hapat që do t'i ndërmarrë ndaj kompanisë “Hidriodrini”. “Kompania Rajonale ‘Hidrodrini’ nuk do ta ketë Deçanin më nën menaxhim. Do të jetë një kompani komunale, e cila do të ketë adresim dhe do të ketë në dispozicion edhe taksat e qytetarëve të Deçanit”, ka deklaruar Ramosaj.

**“Epoka e re”:** Z. Ramosaj, si ka qenë të enjten gjendja me helmime në komunën e Deçanit?

**Ramosaj:** Në raport me ditën e mërkurë, të enjten situata është

dukshëm më e mirë.

**“Epoka e re”:** Sa qytetarë kanë kërkuar ndihmë mjekësore në 24 orët e fundit?

**Ramosaj:** Gjatë kësaj periudhe kohore kanë kërkuar ndihmë mjekësore 284 persona. Këtu bëjnë pjesë edhe recidivistët, pra njerëzit që kanë kërkuar më shumë se një herë ndihmën e mjekut.

**“Epoka e re”:** Deri më tani sa është numri i qytetarëve që kanë kërkuar ndihmë mjekësore?

**Ramosaj:** 1 392 njerëz kanë kërkuar ndihmë dhe kanë marrë tretman mjekësor. Pra, i kanë marrë ilaçet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan. Prej këtyre personave ka dikush që ka marrë shërbimin e dytë, shërbimin e tretë, sepse ashtu parashohin parametrat mjekësore që helmimi të trajtohet derisa të kalojë tërësisht.

**“Epoka e re”:** Si është gjendja e të helmuarve? Është përqësuar gjendja e ndonjërit?

**Ramosaj:** Gjendja e gjithë të helmuarve është stabile. Nuk

kemi ndonjë përkeqësim të gjendjes së tyre.

**“Epoka e re”:** Është raportuar se disa qytetarë kanë kërkuar ndihmë mjekësore edhe në spitalin rajonal të Pejës?

**Ramosaj:** Ka disa qytetarë që kanë shkuar në spital dhe kanë marrë ndihmën e nevojshme mjekësore dhe janë kthyer në shtëpi. Nuk është hospitalizuar asnjë prej tyre.

**“Epoka e re”:** Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) bëri me dije se nga mostrat e ujit, të marra në Deçan më 12 korrik, janë identifikuar disa baktere të cilat mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm. Cili është komenti juaj për këto rezultate?

**Ramosaj:** Ne si komunë dhe si Shtab Emergjent kemi qenë këmbëngulës për të marrë një përgjigje nga institucionet që kanë rëndësi shkencore dhe që kanë përgjegjësi në këtë shtet. Kjo përgjigje tani është marrë. E kemi parë si shqetësim kur ditën e hënë analizat kimike të ujit kanë dalë në rregull, pastaj ditën e martë analiza tjetër ka treguar që në aspektin biologjik

uji është i përdorshëm. Por, kur u bënë analizat më të thella, doli se nuk është krejt në rregull. IKShPK-ja ka dhënë edhe rekomandime se si duhet të vepron.

**“Epoka e re”:** Tash e tutje si do të vepron si komunë?

**Ramosaj:** Kompania Rajonale “Hidrodrini” nuk do ta ketë Deçanin nën menaxhim. Do të jetë një kompani komunale e

cila do të ketë adresim dhe do të ketë në dispozicion edhe taksat e qytetarëve të Deçanit. Kjo kompani do të jetë me standarde më të larta që i plotëson kriteret për t’iu gjendur afër qytetarëve të Deçanit si në cilësi të ujit dhe në aspektin e furnizimit me ujë 24 orë, shtatë ditë në javë.

**“Epoka e re”:** Në dy ditët e fundit kemi parë një reagim të

qeverisë ndaj situatës në komunën tuaj. Cili është vlerësimi juaj për reagimin e qeverisë?

**Ramosaj:** Veprimi i qeverisë ka qenë tepër i vonuar sepse, siç dihet, rastet e para të helmimit kanë ndodhur ditën e shtunë. Pra, për katër ditë ne si komunë jemi përballur krejtësisht të vetëm me menaxhimin e situatës, ndërsa reagimi i qeverisë ka ndodhur ditën e

martë. Fillimisht mbështetja e tyre ka qenë deklarative, më pas edhe me veprime konkrete. Natyrisht se mbështetja e tyre na ka lehtësuar menaxhimin e situatës.

**“Epoka e re”:** Disa media kishin ngritur dyshimet për përfshije në këtë situatë të dy serbëve, duke pretenduar se ata kanë mundur të hedhin diçka në pusët e hapura. Cili është

komenti juaj ndaj këtyre pretendimeve?

**Ramosaj:** Ajo nuk lidhet me këtë rast. Ajo është një farsë që kanë ngritur dy-tre qytetarë. Besoj se ata e kanë pasur qëllimin e mirë, sepse kanë dashur t’i informojnë institucionet, mirëpo ne jemi në dijeni të kësaj pamje prej 25 qershorit. Kështu që rasti i atyre dy serbëve nuk ndërlidhet me situatën aktuale.



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE I KOSOVËS (IKShPK) KA DALË ME ANALIZË PËR HELMIMIN E MBI 1 300 QYTETARËVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

## Gjenden baktere në ujin e pijshëm të Deçanit

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se nga mostrat e ujit, të marra në Deçan më 12 korrik, janë identifikuar disa baktere që mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm. Ky institut ka njoftuar se ekzaminimet mikrobiologjike në mostrat e pranuar nga pacientët me shenja të infeksionit janë duke vazhduar. IKShPK-ja, pas analizave, ka dhënë dhjetë rekomandime për ta menaxhuar këtë situatë

**EPOKA ERE**

**M. KOCI**

**DEÇAN, 15 KORRIK** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije të enjten se nga mostrat e ujit, të marra në Deçan më 12 korrik, janë identifikuar disa baktere që “mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm”. Institucionet shëndetësore në Deçan, qysh në fundjavë, janë duke u përballur me fluks pacientësh që raportojnë simptoma të

helmimit. Sipas të dhënave nga kjo komunë, 1 392 persona kanë kërkuar ndihmë në Qendrën e Mjekësisë Familjare.

IKShPK-ja ka njoftuar se ekzaminimet mikrobiologjike në mostrat e pranuar nga pacientët me shenja të infeksionit janë duke vazhduar. “Ekipet e IKShPK-së nga të gjitha rajonet e Kosovës vazhdojnë punën në terren, duke punuar intensivisht për gjetjen e shkakut të shpërthimit epidemik”, thuhet në komunikatën e IKShPK-së.

Ky institut, pas analizave, ka

dhënë dhjetë rekomandime për qytetarët e Deçanit. “1. Të shtohet kontrolli i inspeksionit sanitar dhe shëndetësor për ngritjen e nivelit të raportimit të rasteve dhe saktësinë e të dhënave për pacientët; 2. Të shtohet kontrolli i inspeksionit sanitar dhe mjedisor për identifikimin e kycjeve ilegale në rrjetin e ujësllësit; 3. Në mungesë të ujit nga rrjeti i ujësllësit të sigurohet uji higjienik për pije nga cisternat e kompanisë ujore komunale deri në normalizimin e gjendjes në të

gjitha fshatrat e komunës së Deçanit, pa marrë parasysh a kanë apo jo raste të dyshimta me simptoma gastrointestinale; 4. Furnizimi i banorëve me ujë të ambalazhuar për pije dhe për përgatitje të ushqimit; 5. Pas rikthimit të ujit në rrjetë rekomandohet që uji të përdoret vetëm për amvisëri dhe higjienë deri në rekomandimin e ri; 6. Kompania ujore publike ta përforcojë kontrollin dhe rregullisht ta dezinfektojë ujin dhe të shtojë inspektimin e resurseve ujore, kontrollin e kaptazhave dhe pusëve të ujit dhe në secilin rast individual të intervenohet menjëherë sipas nevojës; 7. Ujësllësi t’i furnizojë qytetarët me ujë higjienik për pije me orar normal, për ta pamundësuar kontaminimin dhe për parandalimin e epidemive hidrike; 8. Ekipet e ujësllësit rajonal t’i deblokojnë

nyjat e kanalizimeve, të gjejnë pikat e dobëta në rrjet, ku përzihet uji i ujësllësit me kanalizim dhe gropa septike; 9. Të ndalohet rreptësisht kycja e pusëve (bunarëve) në rrjetin e ujësllësit; 10. Të ofrohet ndihma e nevojshme për të gjithë pacientët e sëmurë”, është thënë në rekomandimet e IKShPK-së.

Deçani furnizohet me ujë nga ujësllësi rajonal “Hidrodrini”. Kjo kompani furnizon me ujë edhe komunat: Pejë, Istog, Klinë dhe Junik.

Mirëpo të enjten gjatë një konference për media kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se “Hidrodrini” nuk do ta ketë në menaxhim komunën e Deçanit për menaxhimin e ujërave. Ai ka bërë me dije se tash e tutje do të jetë një kompani komunale e cila t’i përmbushë kriteret për të qenë në shërbim të qytetarëve të Deçanit.

## Së shpejti nis rregullimi i hyrjeve banesore në Kamenicë

**KAMENICË, 15 KORRIK (ER)** - Komuna e Kamenicës, përkatësisht kryetari i komunës, Qëndron Kastrati, ka nënshkruar marrëveshje me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, për mbështetje financiare në projektin "Rregullimi i hyrjeve banesore". I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka thënë se është shumë i lumtur që në

Kamenicë po bëhet punë e vazhdueshme në infrastrukturë. "Së shpejti nis rregullimi i hyrjeve banesore. Me ministrin e MAPL-së, Elbert Krasniqi, nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi për mbështetjen financiare për rregullimin e hyrjeve banesore në Kamenicë. Nga 65 mijë euro, sa është paraparë vlera e projektit, 22 mijë euro do të ndahen nga komuna,

kurse pjesën tjetër do të na mbështesë ministria. Tejet i lumtur që në Kamenicë po bëjmë punë të vazhdueshme në infrastrukturë si një nga investimet e nevojshme të qytetit tonë", ka thënë Kastrati. Vlera totale e këtij projekti është 65 mijë euro. Komuna nga buxheti i saj do të ndajë për këtë projekt mbi 22 mijë euro, ndërsa MAPL do të ndajë mbi 42 mijë euro.



## Brenda një muaji Skenderaj do të bëhet me qendër inovative

**SKENDERAJ, 15 KORRIK (ER)** - Kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të organizatës amerikane "World Hope" për Kosovë dhe Shqipëri, Ken Bishop, i cili është duke dhënë kontribut të madh për rininë tonë përmes përkrahjes së tyre me trajnime të ndryshme dhe realizim të aktiviteteve rinore. "Keni ka një respekt të jashtëzakonshëm për shtetin dhe popullin tonë, kjo dëshmohet edhe me një rast ku djali i tij gjatë ceremonisë së diplomimit në Amerikë, krahas

flamurit amerikan, ka mbajtur edhe flamurin tonë kombëtar. Së fundi Keni është duke investuar në ndërtimin e qendrës inovative në komunën tonë, e cila do të përfundojë brenda një muaji dhe kështu do të jetë gati për të rinjtë e Skenderajt", ka thënë Jashari.

Në shenjë falënderimi për përkrahjen dhënë të rinjve, kryetari Jashari i ka dhuruar Ken Bishopit stemën e komunës së Skenderajt dhe e ka siguruar se do të vazhdojnë të bashkëpunojnë për realizim të projekteve të tjera.



## Shenjzohen vendndaljet e autobusëve në Drenas



**DRENAS, 15 KORRIK (ER)** - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, është duke vazhduar realizimin e projekteve në terren për të mirën e përgjithshme të qytetarëve dhe sigurinë e tyre në komunikacion. Në kuadër të projektit për shenjzimin e rrugëve, ka vazhduar edhe shenjzimi i vendndaljeve për autobusët në territorin e komunës së Drenasit, projekt ky i cili ndihmon në orientimin dhe sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Ky projekt është mirëpritur nga qytetarët të cilët kanë theksuar se me të po sigurohet qasje e lirë dhe e sigurt i pjesëmarrësve në

komunikacion. Drejtresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapci, ka theksuar se do të vazhdojnë të punojnë për ofrimin e shërbimeve më të mira për sigurinë e udhëtarëve. Muaj më parë, DSHPE-ja ka bërë shenjzimin vertikal dhe horizontal në rrugët kryesore brenda qytetit dhe në fshatra, ku në kuadër të këtij projekti është bërë plotësimi i sinjalizimit të vendkalimeve hekurudhore, duke i pajisur me shenja sinjalizuese siç janë shenjat stop, kryqi i andreut, shenjat për praninë e binarëve, shenjat që paralajmëron praninë e trenit, sinjalizimi i rrugëve lokale, shenjat kufizim i shpejtësisë, të rrezikut dhe fëmijët në rrugë.

## Mbi 200 shtëpi të fshatit Tupec kanë mungesë të ujit të pijes

**PRIZREN, 15 KORRIK (ER)** - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Prizrenit, Shaqir Totaj, është takuar me kryetarin e fshatit

Tupec të Hasit, me të cilin ka biseduar rreth problemeve të mungesës së ujit të pijes në dy javët e fundit. "Edhe përkundër ekzistimit të rrjetit të

ujësjellësit, përsëri ujë nuk ka, për më tepër askush nga qeveria lokale në Prizren fare nuk kontakton me lagje e cila i ka mbi 200 shtëpi dhe mbi 1000 banorë.

Banorët kanë mbledhur nënshkrime dhe mendojnë të kycen në furnizim me ujë nga Radoniqi i Gjakovës", ka shkruar Totaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Diskutohet për draftin fillestar të Projektligjit për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 KORRIK - Të enjten ka filluar punëtorja dyditore (15 - 16 korrik) lidhur me diskutimin e draftit fillestar të Projektligjit për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar në të cilën, përveç zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, të pranishëm janë përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, atyre ndërkombëtare si dhe ekspertë të pavarur.

Në fjalën e tij hyrëse, zëvendësministri Blerim Sallahu fillimisht u ka uruar mirëseardhje të pranishmëve duke vënë theksin në rëndësinë e kompletimit të ligjit. Sipas Sallahut, ky projektligj i cili do

të përmbajë dispozita materiale dhe procedurale ka për funksion kryesor kthimin e pasurisë së marrë në mënyrë të kundërligjshme. Sipas tij, pasuria e cila u është marrë qytetarëve pa bazë ligjore, do t'u kthehet si pronarë kushtetues dhe ligjorë të kësaj pasurie në mënyrë që të mbrohet dhe realizohet interesi i përgjithshëm publik.

Drafti fillestar i Projektligjit i cili është rezultat i kontributit të anëtarëve të Grupit Punues përcakton organet kompetente për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, mënyrën dhe procedurën e verifikimit të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme të subjekteve ndaj të cilëve do të



bëhet verifikimi dhe konfiskimi, bazuar në standarde kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Projektligji do të diskutohet gjatë

dy ditëve të punëtorisë, me synimin e kompletimit të tij, rëndësia e të cilit është kryesore në luftimin dhe ndjekjen e këtij lloji të

keqpërdorimit dhe përfitimit të paligjshëm. Punëtorja mbështetet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - OSBE.

## Mbahet punëtorja 'Prishtina e secilit'



PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me "Friedrich Ebert Stiftung", ka organizuar të enjten një punëtori, në të cilën ka diskutuar për mundësitë e përkrahjes për ofruesit e shërbimeve sociale në komunën e Prishtinës në kuadër të platformës "Prishtina e secilit". Në këtë punëtori u ftuan përfaqësues të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime direkte sociale për grupet e marginalizuara, para të cilëve u prezantua platforma e iniciuar nga komuna dhe e cila përbën një tërësi të masave konkrete që për qëllim përfundimtar kanë

avancimin dhe fuqizimin e pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara, të diskriminuara e rrezikuara në Prishtinë.

Në këtë punëtori u dëgjuan përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ekspertëve dhe të ofruesve të shërbimeve që trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat e grupeve të marginalizuara, në mënyrë që ofrimi i përkrahjes financiare nga komuna të bëhet me vendim të mirinformuar në bashkëpunim me të gjithë aktorët në këtë fushë. Po në këtë takim u bë regjistrimi për punëtoritë tematike që do të mbahen në javët në vijim.

## Në QKUK kryhet një intervenim i rrallë



PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është realizuar për herë të parë intervenimi kirurgjik, mjaft kompleks, me qasje anale pa hapje të barkut, reseksioni rectosigmoidal 80 cm me anastomozë colo-anale për shkak të prolapsit rektosigmoidal

(daljes së zorrës së trashë përmes anusit) me gangrene dhe perforacion të zorrës së trashë për shkak të prolapsit.

Pacientja 28-vjeçare, e cila kishte vuajtur me herët nga kapsllëku dhe fryrja e barkut, kishte dalje të zorrës së trashë përmes anusit afro një metër. Ekipi kujdestar i Kirurgjisë

Abdominale, i asistuar nga ekipi i anestezionit, realizuan intervenimin kirurgjik, duke resekuar kolonin rektosigmoidal me anastomozë colo-anale, sipas procedurës Altmeier.

Pacientja është liruar në shtëpi gjashtë ditë pas operimit, në gjendje të mirë shëndetësore.

## 105 raste aktive me Covid në Kosovë

EPOKA  
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës nga 1 467 testime, katër qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të enjten janë shëruar edhe pesë

qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 514.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 105.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 11 513 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 293 693 doza të vaksinës. Deri më sot 78 298 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



# BERZh-i, BE-ja dhe Austria mbështetin eficiencën e energjisë së ndërtesave të banimit në Kosovë

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Më shumë pronarë të shtëpive dhe banesave në Kosovë do të jenë në gjendje të investojnë për përmirësimin e eficiencës së energjisë të shtëpive dhe banesave të tyre falë linjës së re të kreditit prej 5 milionë eurosh që Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka siguruar për Raiffeisen Bank Kosova. Raiffeisen Bank do t'u japë kredi pronarëve privatë të shtëpive dhe banesave për investime për masa të eficiencës së energjisë, si izolimi, dritaret, pompat e nxehtësisë dhe

panelet diellore. "Linjë krediti prej 5 milionë eurosh për Raiffeisen Bank për kreditim të pronarëve të shtëpive dhe banesave. Linjë krediti prej 5 milionë eurosh për investime për eficiencë të energjisë së shtëpive dhe banesave. Huamarrësit do të marrin deri në 20 për qind kthim të parave të investuara me sukses. GEFF bashkëfinancohet nga BE-ja, Austria dhe Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor", është thënë në njoftimin e EBRD. Sipas këtij njoftimi, pas realizimit me sukses të projekteve, huamarrësit do të kenë të drejtë deri në 20 për qind kthim të parave.

"Financimi është pjesë e programit prej 135 milionë eurosh për Instrumentin e Financimit të Ekonomisë së Gjellbër (GEFF) për Ballkanin Perëndimor, i cili mbështet zgjidhjet me eficiencë të energjisë për ndërtimin e një ekonomie më të gjellbër dhe të qëndrueshme. Programi bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian, Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe Ministria Federale Austriake e Financave. Deri më sot më shumë se 1 000 amvisëri në Kosovë i kanë realizuar përmirësimet e eficiencës së energjisë në shtëpitë dhe banesat e tyre duke përdorur

kreditë nga GEFF", është thënë në njoftim. Neil Taylor, shefi i BERZh-it në Kosovë, ka thënë se Kosova thjesht nuk duhet ta humbasë mundësinë për rimëkëmbje të gjellbër pas krizës. Kurse Robert Wright, drejtor ekzekutiv i Bankës Raiffeisen në Kosovë, ka thënë se Banka Raiffeisen në Kosovë është shumë e kënaqur me bashkëpunimin me EBRD për të lëshuar 5 milionë euro kredi me qëllim të përmirësimit të eficiencës së energjisë në shtëpitë e klientëve të tyre. GEFF zbatohet nën mbikëqyrjen e programit rajonal për eficiencë të

energjisë për Ballkanin Perëndimor, financohet nga BE-ja dhe realizohet në partneritet me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Deri më sot, mbi 8 000 amvisëri në Ballkanin Perëndimor e kanë përmirësuar eficiencën e tyre të energjisë përmes programit GEFF, me investime në projekte që kanë kontribuar për uljen e gati 12 000 tonelatave të emetimeve të CO2, e barasvlershme kjo me heqjen e 7 270 automjeteve nga rrugët. Që nga fillimi i operacioneve të veta në Kosovë në vitin 2012, BERZh-i ka investuar 528 milionë euro përmes 77 projekteve të realizuara në vend.



## Përfaqësuesit e OAK-ut diskutojnë me Aliun për problemet e bizneseve



**PRISHTINË, 15 KORRIK (ER)** - Diskutimi rreth vendosjes së moratoriumit për sektorin e gurthyesve, pagesa e taksës së dyfishtë për bizneset e peshkut, asfaltimi i rrugës për bizneset në zonën në Harilaq, anëtarësimi i Kosovës në CEMT, për krijimin e lehtësirave për bizneset transportuese, trajtimi i rëndësisë së Ligjit për Tregti të Brendshme, problemet dhe ngritja e koston për pajisjen me Karton të Gjellbër

për kamion, mungesa e sinjalistikës dhe njoftimi në radio për ngarkesat në rrugë ishin disa nga pikat kyçe të cilat u trajtuan gjatë takimit të përbashkët në mes të përfaqësuesve të OAK-së dhe ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Liburn Aliu. Përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës kanë njoftuar ministrin Aliu rreth aktiviteteve dhe propozimeve konkrete të kësaj

ode, duke potencuar shqetësimin e sektorit të gurthyesve pas deklaratës publike të ministrit Aliu për vendosjen e moratoriumit për këtë sektor. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka falënderuar përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës për iniciimin e këtij takimi dhe ofruar përkrahjen e tij në temat e shtjelluara në këtë takim.

## Kryetari i Bordit të ARKEP-it: Asnjë operator ilegal nuk ofron shërbime në vend

**PRISHTINË, 15 KORRIK (ER)** - Komisioni për Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Naim Rahimi, kryetar i Bordit të ARKEP-it, ka deklaruar se kodi +383 i takon territorit të Kosovës. Ai ka thënë se nga informatat që

kanë deri tash nuk e kanë të identifikuar asnjë operator ilegal që ofron shërbime në vend. "Kodi +383 ka qenë i arritur në marrëveshjen e vitit 2016 dhe i takon territorit të Kosovës, pavarësisht që nuk shënon aty republika. Në bazë të informatave nuk kemi të identifikuar operator ilegal që ofron shërbime në Kosovë", ka thënë Rahimi.

Kurse deputeti i LV-së, Armend Muja, ka pyetur se kodi prej +383 në pronësi të kujt është. "A mund të na sqaroni se në pronësi të kujt është kodi +383?", ka pyetur Muja. Rrezarta Duraku-Rizaj nga ARKEP-i ka thënë se duhet të trajtohet me seriozitet Ligji për Sigurinë Kibernetike pasi, sipas tij, vetëm atëherë mund t'i kenë të qarta kompetencat që u takojnë.





# Ndodhi e jetuar



**Nga: Leo Tolstoy  
Përktheu: Miltiadh BODE**

Midis Francës dhe Italisë, në bregun e Detit Mesdhe, ndodhet një mbretëri e vogël, shumë e vogël. Kjo mbretëri quhet Monako. Në këtë mbretëri ka më pak banorë sesa në një fshat të madh, gjithsej shtatë mijë banorë, ndërsa tokë, as një hektar për frymë. Por, në mbretërinë e vogël ka edhe një mbret të vërtetë. Ky mbret ka edhe pallat, ka oborrtarë, dhe ministra, dhe arkieri (drejtuesit e fesë), dhe gjeneralë dhe ushtri. Ushtria është e vogël, gjithë gjashtëdhjetë vetë, por sidoqoftë, është ushtri. Të ardhurat e mbretërisë janë të pakta. Taksat janë, si kudo, edhe për duhanin, edhe për verën, edhe për rakinë, edhe taksë për frymë; edhe pse pinë alkoool dhe duhan, dhe populli është i vogël, mbreti nuk do të kishte me se t'i ushqente oborrtarët e tij dhe nëpunësit apo të ushqejë edhe vetë, po të mos kishte të ardhura të veçanta. Por, e ardhura e veçantë e tij në mbretëri vinte nga lojërat e fatit – ruletat. Njerëzit luajnë, humbasin, fitojnë, veç ama pronari gjithmonë fiton. Por, pronari nga të ardhurat i paguan mbretit shumë para. Dhe, i paguan shumë para sepse tani ka mbetur e vetmja kompani lotarie në të gjithë Evropën. Më parë kishte të tilla lojëra fati edhe te princat e vegjël gjermanë, por ato i ndaluan dhjetë vjet më parë. Dhe, i mbyllën për arsye se ato sillnin shumë të këqija. Do të vijë dikush, do fillojë të luajë, shpërthen tërë inat, i harxhon të gjitha ç'ka, biles edhe paratë e botës, dhe pastaj, nga inati ose nxehet, ose qëllon. Gjermanët i ndaluan princat e tyre, kurse mbretin e Monakos nuk e ndalon askush: kështu që, vetëm tek ai është ruajtur kazinoja. Nga ajo kohë të gjithë bixhozhinjtë

shkojnë atje, luajnë dhe humbasin, ndërsa pronari fiton gjithnjë. Nga punët e ndershme nuk grumbullon dot, pak nga pak para, për pallate guri. Edhe mbreti i Monakos e di që kjo është punë e pistë, por si t'ia bëjë? Duhet jetuar. Edhe nga rakia, edhe nga duhani nuk është më mirë të ushqehesh. Kështu jeton ky mbret i vogël; mbretëron, para grumbullon dhe i zbaton në pallatin e tij të gjitha rregullat si të gjithë mbretërit e mëdhenj. Kështu, ai edhe kurorëzohet, edhe dalje bën, edhe shpërblime, apo dekorata shpërmdan, edhe dënon me vdekje, edhe fal, po ashtu ka parade, dhe këshilla, dhe ligje, dhe gjyqe. Gjithçka si tek mbretërit e vërtetë. Vetëm se gjithçka është e vogël. Po ja, ndodhi njëherë, pesë vjet më parë tek ky mbret, pra në këtë mbretëri, një vrasje; populli është i butë, paqësor dhe të tilla gjëra nuk para ndodhin këtu. U mblodhën gjyqtarët dhe filluan të gjykojnë me ndershmërinë më të madhe gjithçka siç duhet. Dhe gjykatësit, dhe prokurorët, dhe personat e betuar dhe të zgjedhur nga populli, dhe avokatët. Gjykuan dhe stërgjykuan sipas ligjit dhe dënuan fajtorin, po sipas ligjit, me prerjen e kokës. Mirë, vendimin ia paraqitën mbretit. Mbreti e lexoi vendimin dhe e miratoi. Ta ekzekutojmë me prerjen e kokës, atëherë, kështu të bëhet. Vetëm kishte një të keqe: ata, në mbretërinë e tyre, nuk kanë as gjyotinë për të prerë kokën, as xhelat. U menduan sa u menduan, më në fund vendosën t'i shkruajnë letër qeverisë franceze me kërkesën: nëse ka mundësi, ata të dërgojnë përkohësisht gjyotinën dhe xhelatin për t'i prerë kokën fajtorit dhe po pati mundësi, të njoftojnë sa para duhen për këtë punë. Ia dërguan letrën. Pas një jave morën përgjigje: Ne mund të dërgojmë gjyotinën dhe xhelatin për gjashtëmbëdhjetë mijë franga.

Njoftuan mbretin. Mbreti u mendua sa u mendua dhe tha: gjashtëmbëdhjetë mijë franga! "Nuk ia vlen të shpenzojmë për të poshtrin aq para. A nuk mund të bëhet më lirë? Se me gjashtëmbëdhjetë mijë franga do të thotë që t'i vëmë shumë se dy franga taksë çdo banori. Kjo do të na rëndojë shumë. Mos na bëjnë revoltë." Mblodhën Këshillin dhe rrahën mendime: si ta zgjidhim këtë punë? Vendosën t'i dërgojnë letër – kërkesë mbretit Italian. Qeveria franceze është republikë, nuk i respekton mbretërit, kurse mbreti Italian, sidoqoftë, është vëllai i tyre, mbase do të na e japë më lirë. I shkruan letër; marrin përgjigje shpejt. Qeveria italiane do të dërgojë edhe gjyotinën, edhe xhelatin me kënaqësi. Të gjitha, bashkë me udhëzimin, kushtojnë dymbëdhjetë mijë franga. Më lirë është, po sidoqoftë shtrenjtë. Përsëri, nuk kushton i poshtri kaq para. Na duhet të vëmë nga dy franga për njëri. Përsëri u mblodh Këshilli. U menduan sa u menduan dhe thanë: nuk ka mundësi vallë më lirë? Nuk mund të merret vallë ndonjë prej ushtarëve, që t'ia presë kokën, si therin gjënë e gjallë në shtëpi? Thirrën gjeneralin. "Si nuk mund të gjendet një ushtar i tillë, që t'i presë kokën? Një lloj sikur i vrasin në luftë. Ushtarët për të vrasurë i përgatisin". Gjenerali foli me ushtarët nëse mundet ndonjë ta bëjë këtë. Asnjë ushtar nuk doli. "Jo, thonë ata, ne nuk mund ta bëjmë këtë dhe as që nuk kemi mësuar." Si t'ia bëjmë? Përsëri u menduan dhe u menduan, mblodhën komitetin, komisionin, nënkomisionin. Ndërruan mendim. Duhet, thanë, ta zëvendësojmë dënimin me vdekje, me burgim të përjetshëm. Dhe mbreti do të tregohet i mëshirshëm dhe do të bëjmë më pak shpenzim. Mbreti

pranoi dhe kështu vendosën. Por, ka një të keqe, se nuk ka burg të veçantë për burgim të përjetshëm. Ka burgje më të lehtë, ku i burgosin përkohësisht, por burg të fortë e të sigurt, për t'i mbyllur për jetë, të tillë s'ka. Megjithatë gjetën një ambient. E futën djalosin. I vunë edhe një roje. Roja edhe ruante, po edhe vinte në kuzhinë të merrte ushqim në pallat për të burgosurin. Djaloshi ri këtu gjashtë muaj, ri një vit. Mbreti filloi të verifikojë shpenzimet dhe të ardhurat në fund të vitit dhe shikon: shpenzimet për të mbajtur kriminelin ishin të mëdha. Fut këtu edhe rojën, edhe ushqimin. Të gjitha këto kushtonin gjashtëqind franga në vit. Ndërsa djaloshi është i vogël, i shëndoshë, mund të rrojë pesëdhjetë vjet. Pa bëj hesap sa do të shkojnë. Janë shpenzime të mëdha. Nuk bën kështu. Mbreti thirri ministrat: "Mendoni, thotë ai, si t'ia bëjmë me këtë kopuk, për të larë hesapet me të (për ta hequr qafe). Sepse ai do të na kushtojë shtrenjtë." U mblodhën mbretërore për të ngrënë drekë. Mori çfarë i dhanë, u këthye në burg, mbylli derën dhe rrinte. Të nesërmen bëri të njëjtën gjë. Shkon për të marrë ushqimin, por për t'u larguar nuk largohet. Si t'ia bëjmë? U menduan thellë. Duhet t'i themi hapur se ai nuk na duhet. Le të dalë nga burgu dhe të ikë. Mirë. E thirri ministri i Drejtësisë dhe i tha: "Pse nuk largoheni nga burgu, të dilni i lirë? I roje s'ke më, s'te ruan njeri. Mund të largohesh lirisht dhe mbreti nuk do të fyhet." – "Mbreti nuk do të fyhet, por unë nuk

kam ku të shkoj. E ku do të shkoj unë? Ju me dënimin që më dhatë, më turpëruat, tani mua nuk do të më marrë asnjë në punë. Unë jam shkarkuar nga të gjitha punët". "Ju", thotë ai, "nuk silleni drejt me mua. Kështu nuk ia vlen të bësh gjë. Se ja, më dënuat ju me vdekje, me prerje koke, mirë. Atëherë, duhej që ju të më prisnit kokën, por ju nuk e bëtë këtë. Kjo është e para. Unë nuk kundërshtova. Më vonë më dënuat me burgim të përjetshëm, më caktuat edhe roje, që ai të më sillte ushqimin, pastaj më hoqët rojën. Kjo është e dyta. Përsëri unë nuk thashë gjë, s'kundërshtova. Shkoja vetë për të marrë ushqimin. Tani ju më thoni: largohu, dil nga burgu. Jo, ju bëni si të doni, por unë nuk do të shkoj askund." Si t'ia bëjnë? Mblodhën përsëri Këshillin. Ç'të bëjnë? Ai nuk largohet. U menduan dhe vranë mendjen shumë. Duhet t'i caktojnë pension. Pa një gjë të tillë, nuk mund të shpëtojnë dot prej tij, nuk e heqin dot qafe. Njoftuan mbretin. "S'kemi ç'bëjmë", tha, "le ta heqim nga sytë në njëfarë mënyre. Na mbeti në reze". "Të caktuam gjashtëqind franga pension", i thanë. "Atëherë, mirë", "tha ai, "në qoftëse do të më paguani me siguri, besoj se do të largohem nga burgu." Ja, më në fund, vendosëm kështu. Ai mori një të tretën e parave në fillim, u përshëndet me të gjithë dhe u largua nga prona e mbretit. Ai bëri gjithsej një çerek ore udhëtim me tren. Doli, u vendos me shtëpi sa më afër, bleu tokë, veseliti një kopsht, bahçe, dhe jetonte mirë dhe i gëzuar. Në afatin e caktuar shkon e merr pensionin. E merr, shkon në kazino, vë dy-tre franga, nganjëherë fiton, nganjëherë humbet, dhe shkon në shtëpinë e vet. Jeton i qetë dhe mirë. Sa mirë që mëkati me të nuk ndodhi atje ku nuk i kursejnë paratë, as për t'i prerë kokën njeriut, as për burgim të përjetshëm.



NORMAN MAILER

# VETËVRASJA E HEMINGUEJT DHE MONROES

Kolumnisti ju paralajmëron. Këto shkrime janë shkruar dy muaj para publikimit. E bukura e gjithë këtyre është të duket diçka interesante për gjashtëdhjetë ditë. Për këto shkrime isha duke folur me një kolumnist. “Shkruaje kolumnën në atë mënyrë që njerëzit do të mund ta lexonin me kënaqësi edhe dhjetë vjet më vonë” më tha ai. Këshillë shumë e mirë. Në vazhdimësi do të përpiqem t’ju rrëfej çfarë kam për të thënë. Disave prej jush do të përpiqem t’ju çoj në një vdekjeje të hershme.

Këtë javë kishim lajme të bollshme në lidhje me Marilyn Monroen dhe drogën e njohur Thalidomide. Brenda gjashtë-dhjetë ditëve ju do ta harroni emrin e drogës Thalidomide, që është drogë e cila përdoret nga gratë shtatzëna për t’i ndalur dhembjet. Si efekt anësor, kjo drogë kishte shumë ndikim në zhvillimin e embrionit në barkun e nënës. Një efekt tjetër ishte edhe rritja e ekzagjeruar e lopatave në krahë. Në Gjermaninë Perëndimore ishin shënuar pesë mijë raste të njerëzve me këtë

abnormalitet. Ky, mbase, ishte edhe një humor i zi i kohës.

“I dashur”, thotë nusja gjermane, e re dhe shtatzënë, “këto tableta kanë një efekt shumë të çuditshëm tek unë”.

“Mos u mërzi, e dashur” ia kthen burri, “mjeku di se ç’bën”.

Humori ishte me një keqkuptim seksual me kast. Sepse janë burrat ata që nuk u besojnë shumë mjekëve. Gratë i adhurojnë mjekët. Nëse një hero kujdeset aq shumë për të dashurën e tij, ai duhet të futet në një listë konkurrese ndaj Richard Burtonit, Fidel Castros, Jack Kennedyt, Cary Grantit, Paul Gettyt, Yuri Gagarinit, Sinatras, Glennit, i riu Brando ose nga ai mesatari Pinza, nuk ka shumë rëndësi se cili. Natyrisht, nëse njeri e do një grua kaq shumë, ka një shans të tillë. Mos u dorëzo, kështillon kolumnisti. Mos gabo të dorëzohesh, vetëm nëse bukuroshja jote e dashur është një aktore dhe kundërshtari yt (konkurenti) është një mjek ose psikoanalist. Atëherë, është e kotë kjo punë.

“I dashur” thotë nusja gjermane: “Këto tableta kanë një efekt shumë të çuditshëm tek unë”.

“Atëherë, hidhi” i thotë burri.

“A je budalla ti?” i pergjigjet nusja e përlotur. “Mjeku di se ç’bën”.

Unë e njoh një mjek shumë inteligjent, cinik, por një ekspert i mirë në kërkimet për kancerin. Ai është drejtues i një programi në spitalin e Nju-Jorkut. Ai ishte i fascinuar me Thalidomide. Mendonte se ky lloj i drogës kishte sukses. “Do të thoshte që ne me anë të kësaj droge do të mund të ndikojmë/influencojmë procesin e evolucionit”.

“Për çfarë qëllimi?” e pyeta.

Ngriti supet. Nuk jam i interesuar për atë punë. Nuk është fundi i një qëllimi për shkencëtarët në këtë fazë. Në brendësi të njeriut modern ekziston njëfarë lloj agresioni ndaj natyrës. Ti mund ta dëgjosh gjithandej: në zhurmën që ajri i kondicionuar bën, zhurmat e altoparantëve në vetura të cilat parakalojnë në rrugët urbane. Ti mund të ndjesh edhe kur e prek një lodër plastike. E urrej idenë që fëmijët të zbatimen

me lodra plastike. Unë më parë u kisha dhënë atyre kondomë të shpërthyer për lodra.

Pastaj kemi edhe përgjigjen e natyrës së mërziut.

Unë jam i ndarë në dysh, thotë ajri. Hiqmini qafe këta aeroplanë.

Ndal së bërtituri, o zotëri! Ne kemi nevojë që aeroplanët ta arrijnë cakun.

Çfarë caku?

Ec, the qafën, thotë si rrëmbimshëm.

Ndodhia më e çuditshme që kam dëgjuar ndonjëherë për Jack Kennedy ishte kur një herë ai ishte në anijen e tij duke ngrënë mish pule dhe përnjëherë hodhi në ujë gjysmën e mishit të pulës që nuk kishte arritur të hante së bashku me kockat.

Shumë pak njerëz e kuptojnë se çfarë dua të them. Kjo më bën të elaboroj më tej duke konkluduar se morali i kësaj storie është se ti assesi s’duhesh që t’i hedhësh eshtrat e një kafshe në det. Ajo do të duhej të ndodhte në tokë, në dhe e jo në ujë.

Natyrisht që ne hedhim të gjitha mbeturinat në sistemin e

kanalizimeve dhe ai çon gjithçka në det, por çka nuk kemi kuptuar ende ne njerëzit është se të gjitha ato mbeturina na kthehen në tokë pas disa mijëra vjetësh në formën e kancereve të ndryshme, murtaja, kampet e koncentrimin, dështimet e projekteve sociale për strehim, masmedia dhe neveritë, të gjitha këto vijnë nga disa prej veseve sociale, prej prodhimit të pasqyrave, prej kohës kur ne e pushtuam Evropën me cigare, prej avancimeve në sistemin e kanalizimeve. Shkenca u zhvillua vetëm atëherë kur njeriu i dha betimin vetes që ai do ta urrejë natyrën dhe se tërë jetën do t’ia dedikojë kapjes dhe mbyttjes së saj. Asgjë nuk ka të keqe që ta urresh natyrën. Urrejtja ndaj nënës natyrë është më pak e keqe sesa dashuria e një kolumnisti i cili bën çmos që me shumë zor i shtyn lexuesit e tij që ta duan nënën natyrë. Çfarë është më e keqe, po ashtu, është edhe frika nga vdekja. Aq e neveritshme është kjo frikë saqë njerëzit shkojnë aq larg sa duan ta mohojnë se do të vdesin një ditë. Prandaj, hedhja e kockave

të pulës në det është një mosrespekt ndaj traditës së shenjtë të varrimit. Mbase Kennedy i giorë kur kishte hedhur kockat në det kishte bërë duke thënë: "Kërkoj ndjesë, mik i mirë!". Atëherë më e rënda është edhe puna me anekdotat. Kurrë nuk mund t'ua qëllosh nuancave. Më beso se po të isha unë aty, në atë çast kur Kennedy kishte hedhur kockat në det, do të kisha mundur ta di, ta kuptoj nëse ai ishte i pendueshëm apo paraqitej sikurse që ishte një arrogant ose aktronte sikur një gjel shtëpie.

Dikush mund të thotë tashti: "Hajde de lëre tash njeriun rehat! A s'ka të drejtë i ngrati të ketë jetë private?". Përgjigjja ime është: Jo. Ai është një djalë i ri që dëshiron të bëhet president. Kështu që ai do të duhet ta paguajë një pjesë të këtij çmimi. Besoj se ai është gati ta paguajë këtë çmim. Shumë i rrallë mund të jetë rasti kur një mbret ose car nuk do të ketë ndonjë dëshmitar në kupolën e hapjes së ceremonive. A ju kujtohet këtu Arthur Schlesinger?

Rrënjët e vdekjes janë varrimet. Kurrë nuk e kam dashur Joe DiMaggio. Legjenda e tij më ka zhgënjyer paksa, por kam shumë respekt për vendimin e tij që ta lejonte një organizim ceremonial

për varrimin e Marilyn Monroes. Nëse ajo e giora nuk ishte aktore e famshme dhe në vend të ishte ajo një blonde normale atraktive që endet nëpër Hollywood, një pijanece e rregullt dhe frekuentuese e kafeterive aty-këtu, nëse do të kishte qenë një prostitutë e rregullt, thithëse e drogës, e dashur e dikujt aty, ose po të ishte ajo një degjeneruese graduale që kishte dështuar në jetën e saj dhe dalëngadalë po ikte në tualetin e kohës sikurse një racë qeni Spaniel, atëherë ajo do të kishte përfunduar në një sallon bukurie të Hollywood-it me pesëmbëdhjetë shokë të ftuar. Mbase ajo ishte edhe e tillë derisa përfundoi jetën e saj. Tabletat e gjumit janë norma ekuilibri këto ditë. Nëse të gjithë amerikanët do të përpinin nga katër tableta Nembutal për dy mijë net radhazi, atëherë të gjithë do të kishim përfunduar të tillë. Të gjithë do të ishim shndërruar në idiotë.

Cilido shkrimtar që merr tableta të tilla, prej vitit në vit, duhet të jetë në gjendje që të shkruajë një përrallë të bukur të një luftëtari klubi, truri i të cilit shndërrohet në një pijanec të ndëshkuar. Por ky libër kurrë s'do të shkruhet. Ne e mësojmë të vërtetën atëherë kur japim ngadalë disa copëza të

gjuhës sonë, deri atëherë kur na harxhohet e tërë gjuha dhe na mbetet goja e zbrazët. A i bie kjo se atëherë kur do të na humbë gjuha, papritmas ngrehemi në mesin e natës duke shkuar poshtë shkallëve për ta marrë pushkën dhe duke e futur tytën mu në mes të gojës dhe të lansohemi sikurse një raketë! Ja ku jam e vërteta e jetës, unë jam Ernesti, ai i cili të kishte kërkuar gjithë jetën. Tash ti duhet të më gjes, në përjetësi, sepse unë, tashti, jam në copëza krejt të vogla.

Heminguej dhe Monroe. Lehtë mund t'i tejkalojë këta emra. Ata ishin dy njerëzit më të bukur të Amerikës.

Unë mendoj se Ernesti na kishte urryer të gjithëve sa ishte gjallë. Ai na privoi nga koka e tij. Nuk ka edhe shumë rëndësi a ishte vetëvrasje apo një aksident. Njeriu normal nuk do ta fuste tytën e pushkës në gojë dhe të flirtojë me vetëvrasjen duke e shndërruar atë në një aksident duke menduar se hajt njerëzit do të mendojnë që në fund ishte aksident, e sidomos njerëzit sikur Ernesti që ishte shumë i dhënë pas reputacionit të tij. Ishte i zellshëm. Vdekja e tij ishte trishtuese. Thuaje aman. Ishte vdekja më e rëndë në Amerikë që nga vdekja e papritur e presidentit

Rusvelt. Ne ende nuk e kemi marrë veten nga vdekja e Heminguejt. Ne kurrë nuk do ta marrim veten.


Por, megjithatë, vdekja e Monroes ishte krejt ndryshe. Ajo na rrëshqiti nga duart. Ajo na kishte rrëshqitur nga duart prej kohësh. Tashti shumë lehtë e kemi të themi se disi sjelljet e saj ishin të çuditshme kohët e fundit. Unë mendoj se ajo ishte shumë e keqe në "The Misfits", ishte e papërshtatshme dhe kur erdhi koha të tregonte emocione, ajo u duk edhe më e keqe dhe joatraktive. Por, megjithatë, ajo na iku nga duart para disa vjetësh. Nëse ajo do ta kishte bërë Grushenken te Vëllezërit Karamazovë në mënyrën se si ajo kishte thënë se do ta bënte, dhe nëse e kishte realizuar atë që kishte thënë, atëherë ajo do të mbetej gjallë sot. Mbase do të ishte kthyer në një jetë më të pastër, duke u shpërlarë nga kripa e mëkateve të kahershme. Ne i përpimë tabletat në kohë të vështira, atëherë kur aroma e vdekjes na afrohet shumë afër dhe kutërbojmë prej saj. Mbase Monroe kishte menduar se që ajo ta përfitonte përjetësinë, duhej të flijohet. Për Heminguejn, që të jetonte, të mbetej i gjallë, ai do të duhej të shkruante një libër shumë më të mirë sesa *Lufta dhe*

*paqja.*

*Nga Parku i drerëve: Na ishte njëherë një ligj shumë i rëndë i jetës, aq i rëndë saqë diktonte që njeriu në mënyrë që të mbijetonte do të duhej të rritej shumë. Unë mendoj se kjo frazë është aq e rëndësishme edhe sot. Unë mendoj se biologjikisht është më se e vërtetë. Poashtu, mendoj se aplikimi i këtij ligji të jetës është shumë më zellshëm i aplikuar në Amerikë. A e dini pse? Sepse ne përshtillemi përreth kodrinës përderisa mbahemi te të tjerët se ne jemi mbretërit e majës së malit. Aq në thellësi do të shkojë puna me ne saqë një ditë do të qëndrojmë mu në mes dhe do të themi se edhe kjo është e jona, ndërsa kurrë nuk do të ndalemi derisa mbretin do ta mbysim vetë. Amerika jonë e mirë. Ne jemi kombi i mbretërve dhe mbretërshave amatorë.*

Çdo muaj kolumna jonë do të përfundojë me një paragraf të shkurtër. Bëni pak vend për mbretin tonë të vogël të tufës, Roert Ruark. Robert Ruark e ka personalitetin e tillë të Heminguejt vetëm po të ishte Ernest Heminguej një shkrimtar shumë i keq.

**(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Emanuel Bajra)**





INTERVISTË ME POETIN DHE PROFESORIN E LETËRSISË SHQIPE, SALI BASHOTA

# DASHURIA ËSHTË PËRMBAJTJA KRYESORE E JETËS SË NJERIUT

## Bisedoi: Berat ARMAGEDONI

*I nderuar profesor Bashota, intervista, edhe më të gjata se kjo, ndoshta edhe më të bukura, për media dhe për medime të tjera, keni dhënë shpesh. Madje keni dhënë intervistë të gjatë saqë ka zënë vend në një libër prej 200-faqesh, i cili është botuar në gjuhën shqipe, paralelisht edhe në gjuhën angleze dhe franceze. Në atë intervistë jeni përgjigjur për shumëçka nga jeta dhe krijimtaria juaj. Çfarë do të donit të shtonit më tutje?*

Intervista që përmendni ka titullin *Poezia si teori e dashurisë*. Është realizuar nga Gëzim Arifi. Së pari është botuar në librin *Palimpsesti i ideve* (Pamas, 2013), pastaj është botuar në tri gjuhë: në shqip, anglisht (përkthyer nga Avni

Spahiu) dhe frëngjisht (përkthyer nga Bade Bajrami), me titullin *Ego* (Pen Qendra e Kosovës, 2014). Iu kam përgjigjur 33 pyetjeve të cilat ndërlidheshin vetëm me poezinë dhe jo me krijimtarinë time letrare në tërësi. Disa studiues të letërsisë e kanë konsideruar si referencë orientuese për ta njohur poezinë time, por edhe si udhërrëfyes për autorët e rinj. Prandaj, jam i lumtur që është pritur mjaft mirë të lexuesit.

Me këtë rast, për këtë intervistë, kam shumëçka të them për pyetjet që m'i keni bërë për revistën *Akademia* dhe më keni futur në kërkimin e ri të vetvetes nga kujtimet e fëmijërisë e deri më sot. Disa kujtime kanë jetuar e mbijetuar, disa janë harruar e fshirë, disa janë të bukura, disa të tjera janë të pikëllueshme dhe të dhimbshme.

Shpresoj dhe besoj se shumë ide, fakte, kujtime, rrëfime, të

ndodhura, përjetime etj. e sprovonë konceptin tim krijues për një lloj rikthimi në nostalgji jetësore, në njërin anë dhe, për ta ndërtuar mendimin tim, në anën tjetër, pikërisht duke dhënë përgjigje për krijimtarinë time letrare, për letërsinë, për kulturën, për jetën, për dashurinë, për vetminë, për lumturinë, për ëndrrat, për rininë, për procesin krijues, për leximin, për vlerësimin e letërsisë, për probleme sociale dhe kulturore.

Gjithmonë më ka interesuar ndërtimi dhe funksionalizimi i një kuptimi, befasia me gjërat e bukura që ndodhin rrallë në jetë apo superioriteti i pasioneve për ta arritur qëllimin në jetë dhe krijimtari. Gjithsesi, intervista mund të jetë një mundësi interesante për ta shpalosur botën time krijuese me një lloj të rrëfyeri autobiografik, për ta trajtuar praninë dhe ekzistencën e

frymëzimit në veprat e mia. Për më tepër, është një ftesë që e ka gjithmonë pranë kujtesën për frymëzimin dhe pasionin për shkrimin.

*Sali Bashota në moshën e rinisë ka qenë një futbollist shumë i mirë. Po të mos bëheshit profesor letërsie, po të mos i mësonit teknikat e shkrimit të esesë, të recensionit, të poezisë, të prozës poetike, paraqitjen para studentëve pa drojë, a do t'i mësonit teknikat e lojës së futbollit? Pra, a do të bëheshit futbollist?*

Kur isha vetëm gjashtë apo shtatë vjeç ëndërroja të bëhesha futbollist. Isha një nga shumë fëmijët e lagjes së Bashotëve që e donim pa masë futbollin dhe luanim çdo ditë deri në orët e vona të natës. Asnjëherë s'pajtoheshja me humbjet. Si fëmijë e ndieja vazhdimisht se po krijoja një vetëbesim të tepërt në vetvete dhe

ëndërroja se do të bëhesha një ndër futbollistët më të mirë. Më pëlqente përkushtimi ndaj futbollit, sidomos imagjinata e lojës, teknikat e kapërcimit të kundërshtarëve, stili i pasimit të shpejtë të topit, duartrokitjet e shikuesve, përçafimi me simpatizantët e mi. Dëshiroja me këmbëngulje që çdo gjë ta bëja bashkë me lojtarët e ekipit tim për ta fituar lojën, madje me rezultat sa më bindës. Asokohe instinkti im i vetëm ishte se pretendoja të bëhesha i famshëm, pikërisht me lojën e futbollit. Më pëlqenin pa masë fanellat me ngjyrë të kaltër dhe sidomos numri nëntë. Kurrë nuk kisha menduar se numri nëntë do të bëhej edhe simbol i poezisë sime, madje ndjenjë e mrekullimit figurativ edhe në krijimtarinë time letrare.

*Çfarë kujtoni nga fëmijëria, veçan sa ishit në shkollën fillore?*

Kohë fëmijërisë është pjesa më e lumtur e jetës sime, më e dashura,

më e paharruara, më e veçanta. Asnjëherë nuk mund t'i largohem përmallimit të përhershëm për të. Asokohe çdo gjë fillonte me përqafimin e Nënës, me çastet e lumtura të përqafimit, me përmbajtjen e papërshkruar të jetës së gëzuar, me tregimin e përrallave të bukura, me buzëqeshjen, me ëndrrat, me zhurmën e fëmijëve të lagjes me të cilët luanim bashkë, pastaj me dëshirat e shumta se çfarë do të bëhesha kur të rritesha.

Shiu, vjeshta, bora, udhëtimi në orët e hershme të mëngjesit për të arritur me kohë në shkollën e Kijevës, pastaj çastet kur i bëja detyrat e shtëpisë, kur e shtrëngoja fort lapsin për të shkruar bukur dhe drejt, sepse gati çdo ditë ua theyeja majën lapsave dhe, duke i mprehur vazhdimisht, deri në mbrëmje s'mbetej gjë prej tyre. Nëna më qortonte që i shtrëngoja kaq shumë me dy gishtërinjtë e dorës së djathtë. Qortimi i saj më ngjallte besimin për të shkruar bukur, por edhe pa gabime. Gjithashtu, çdo ditë më rrinte gati të mos i harroja librat që i vendosja natën nën jastëk. Sa herë më vlerësonte nëna, sikur fluturoja nga gëzimi i papërmbajtur. Kjo më dukej si një përrallë e bukur për mua sepse çdo gjë më pëlqente që ta bëja sa më parë.

Si fëmijë jam përkujdesur shumë për pëllumbat. Asokohe familja ime kishte shumë pëllumba, pothuajse të të gjitha ngjyrave. Pëllumbat e bardhë më pëlqenin më së shumti. Për herë të parë pata dëgjuar si fëmijë se si i krahasonin pëllumbat me engjëjt. Gjithashtu, nga babai, ndjesë pastë, e pata dëgjuar fjalën gjynah (mëkat). Nuk më merrte gjumi deri vonë duke menduar se a mund të bënin edhe pëllumbat mëkate apo mëkate bëjnë vetëm njerëzit e këqij.

Isha fëmija i parë i familjes, madje shumë i përkëdhelur. Si fëmijë, ndoshta nga ndjenjat e fshehta, i imitoja kënaqësitë e jetës të cilat i jepnin vazhdimisht gjallëri shpirtit tim optimist. Më pëlqenin pa masë ushqimet e ëmbla. Më pëlqente t'i përqafoja të dashurit e mi, por edhe ata ta bënin të njëjtën gjë për mua. Sikur i përvetësoja njerëzit e afërm që të më lavdëronin për shkathhtësinë dhe gjeturinë, pikërisht për të rënë sa më shumë në sy, madje për çdo gjë. Më pëlqente të mbaja flokë të gjatë dhe sidomos ta zgjatja para pasqyrës blenin e flokut i cili më mbërrinte deri nën hundë.

Asokohe shpeshherë vizatoja emra të ndryshëm njerëzish në pluhurin e rrugicave të lagjes sime. Ky qe një nga pasionet e mia, sidomos në ditët e ngrohta të verës. Sa herë binte shi kthehesha në dhomën time të gjumit dhe në dritaret e avulluara vizatoja figura të ndryshme, sidomos zogj, lepuj, mace, por edhe lule, si dhe plisin e babait tim. Tani më kujtohet se si një ditë vjeshte i pata vizatuar edhe krahët e dallëndysheve, duke menduar se ato po fluturonin në qiellin e kaltër.

Nëna vazhdimisht më qortonte pse isha një fëmijë i lazduar, i sikletshëm dhe shumë i parehatshëm. Pothuajse isha i interesuar për çdo gjë që kishte të bënte me kureshtjen për të magji-

nuar apo shpikur diçka interesante në mendjen time. Kjo ishte një lloj magjepsjeje interesante dhe e pazbërthyeshme asnjëherë deri në fund, ndoshta edhe me një lloj habie. Thosha me vetvete si iknin kështu ndjenjat e njeriut dhe ku shkonin ato, o Zot!

Oborri i shtëpisë, pastaj kopshti që e quanim "Ara e selishtave", ishte përplot ftonj dhe kumbulla, ndërsa kishte më pak pemë të tjera. Më pëlqente shumë era e ftonjve. Shpeshherë nëna i mbante në arkë ftonjtë dhe sa herë që e hapte arkën, aroma e tyre e mbushte tërë dhomën. Si fëmijë, gjithnjë e më shumë më mungonin, sidomos gjyshja dhe gjyshi, meqë ata kishin ikur në amshim disa vjet më herët pa ardhur unë në këtë botë. Ndjesinë për mungesën e gjyshit dhe të gjyshes në familje i zëvendësoja me dashurinë që ma ofronin gjyshi dhe gjyshja e dajave, pra prindërit e nënës. Të dy i doja shumë.

Më pëlqente të thosha: unë e kam një dëshirë. Të bëja çfarë dëshiroja vetë, duke shkaktuar zhurmë e padëgjueshmëri. Ajo dëshirë bëhej e papërshkrueshme dhe shfaqej me reagim të shpejtë dhe jo rrallë edhe me hatërmbetje. Nëna ma tërhiqte vërejtjen, ndërkaq babai vetëm më shikonte, pastaj m'i përkëdhelte flokët me një durim të pazakontë derisa më zinte gjumi. Një pjesë të këtyre kujtimeve i kam paraqitur në veprën me prozë poetike *Shkallët e natës*.

Thosha unë kam një dëshirë: t'i këpusja gjetet e pemëve dhe duke i numëruar ato pa i bërë copa-copa. Çuditërisht gjeja nga një epitete apo krahasim, duke përmendur emra njerëzish, kafshësh dhe shpezësh. Më pëlqente këputja e gjetheve dhe loja me to, duke lënë mënjanë zhgënjimin e pamjaftueshëm, përse në të njëjtën çast përbrenda vetvetes kisha edhe gëzim, por edhe frikë. Disi dalëngadalë kjo më shndërrohej në një ves të çuditshëm dhe të pakuptueshëm. Si fëmijë mendoja, sa herë frynin erërat, si fluturonin gjetet e ku shkonin e ku binin, kah e merrnin rrugëtimin e tyre. Loja me gjetet sikur ma krijonte një imazh të çuditshëm, duke më bërë të lumtur, pikërisht për imagjinatën, sepse doja të krijoja diçka të bukur në mendjen time. Po kështu, imazhet e asaj kohe sikur më shfaqen shpeshherë, sidomos në poezitë e shkruara vitet e fundit.

Si fëmijë isha kureshtar i madh ta kuptoja buzëqeshjen e njerëzve. Pse buzëqeshnin njerëzit dhe pse ishin të lumtur? Nga kush do të varej kjo lumturi. Pothuajse ishte një parandjenjë e pazakontë për realitetin e përditshëm, që si fëmijë mund të kisha këto mendime, që nuk ishin më shumë se iluzion, të thosha se kur të rritem do të bëhem njeriu më i buzëqeshur në botë.

Nuk pranoja urdhra, edhe pse kisha shumë kërkese, ankesa dhe lutje. Ndoshta isha fëmija më i çuditshëm që bëja kaq shumë lutje për t'i plotësuar dëshirat e mia. Asokohe kisha mësuar shumë gjëra të rëndësishme, ndër të tjera, ta thosha dhe ta kuptoja gjithmonë të vërtetën. Në atë moshë kisha dëshirë të vishja rroba të bardha dhe rroba të kaltra, si dhe të merrja vetëm pesëshe. Pa masë më

pëlqenin rrëfimet, kur të rriturit i tregonin ëndrrat dhe gjumin e tyre. Ky, mbase, ishte një nga argëtimet më interesante në atë kohë sepse për ëndrrat e mira thoshin që ndjellin fat dhe lumturi, prandaj unë dëshiroja të shihja vetëm ëndrra të bukura. Vokacioni im u zbulua si fëmijë kur bëja hartime të bukura në shkollë, për çka më lavdëronin mësuesit e mi, pastaj kur botoja poezi në gazetën e murit. Gjithmonë ma tërhiqnin vëmendjen njerëzit që kishin ambicie në jetë, njerëzit e zgjuar dhe të qetë, njerëzit që kishin vërtyte dhe që ishin të sinqertë. Isha i bindur se edhe zgjatja dhe shtrëngimi i duarve do të duhej ta kishte besimin e njeriut, miqësinë, përzemërsinë dhe jo dyshimin.

*Çfarë kujtoni sa ishit nxënës në gjimnaz?*

Kur isha gjimnazist në Kijevë, atëkohë në vitet 1974-1978, më kujtohet se vazhdoja prapë pasionin e madh për futbollin, gjithashtu lexoja shumë romane dhe vepra me poezi. Punoja shumë në familje. Shkruaja poezi. Në gjimnaz kam filluar të mendoj më seriozisht për letërsinë. Imagjinoja gjëra të bukura, se si mund të bëhesha njeri i lumtur apo i dashur për të gjithë. Në fakt, ky ves apo vërtet më kishte mbetur kur isha fëmijë. Flisja shpejt, lexoja shpejt, por mendoja ngadalë. Nuk di pse gjithmonë e synoja të pamundurën. Si një nevojë e brendshme shpirtërore, më pëlqenin gjithmonë përshkrimi, këndvështrimi, respekti për njerëzit, atmosfera për të fantazuar të ardhmen e jetës sime.

Më pëlqente tepër gjurmimi i fjalëve që nuk ua dija kuptimin dhe domethënien, por edhe fjalët që më bënin të gëzuar, si: buzëqeshje, dashuri, përqafim, lumturi, besim, shpresë, dituri etj. Kur isha gjimnazist fillova ta kuptoja ndjenjën e fajit, ndjenjën e shqetësimit, ndjenjën e dhimbjes, ndjenjën e kërkimfaljes. Sikur më shkëlqenin sytë nga rrëmbimi i këtyre ndjenjave, sepse isha kureshtar ta dija përmbajtjen dhe kuptimin e tyre të vërtetë.

Më kujtohet kur e pata pyetur profesorin e filozofisë, se cilat janë parimet kryesore të njeriut, pastaj për domethënien e fjalës mëkat, si dhe për padrejtësitë që bëjnë njerëzit. Sikur fjalët e mia përplaseshin njëra mbi tjetrën vetëm për ta arritur efektin e dëshiruar.

Po kështu, ditën tjetër e pyesja profesorin edhe për fjalët që nuk ua dija porosinë. Atëbotë sikur kisha një aftësi të pashprehur për të bërë pyetje të çuditshme, ndonjëherë edhe të pamenduara mirë.

Sikur hulumtoja me admirim në ndërdije vetë realitetin e bindjeve të mia për t'i stërholluar ato në portretizimin e njerëzve që më rrethonin. Isha i padurueshëm me gjërat e paarsyeshme, me inatin, me xhelozinë, me zemërimin të cilat nuk treteshin lehtë në

mendjen time.

Kur profesori i Gjuhës Shqipe na shpjegonte për ngjarje të ndryshme, të cilat shkrimtarët i paraqisnin në veprat e tyre, kryesisht në romane, mendoja se ajo pamje e imagjinuar po bëhej reale para syve të mi. Më pëlqente ana heroike e personazheve në vepra të ndryshme, por më shumë historia e dashurive të mrekullueshme. Kur e lexova për herë të parë dramën *Romeo e Zhyljeta* assesi nuk mund ta bindja veten se si dy personazhet e dashuruara në fund të dramës bënin vetëvrasje. Po kështu, ndieja një dhimbje të pafund për shkrimtarët të cilët kishin vdekur të rinj, siç qe, një nga ta, Migjeni. Më dhimbsej jeta e Zef Serembes, shtegtimi, vetmia, depresioni, krejt të ndërlidhura me dashurinë e tij shpirtërore.

Kuptimin e njohjes për gjëra dhe fenomene të ndryshme e ndërlidhja gjithmonë me dijen dhe besimin. Gjithnjë më interesonte perceptimi i objekteve, sidomos i shkollës ku mësoja, sepse muret e saj ishin veshur me drurë ngjyrë arre. Më shqetësonte çasti apo detaji se çfarë imagjinoja në radhë të parë: formën, përmbajtjen apo përfytyrimin e fantastikës që mbretëronte në mendjen time. Në fakt, fantastike më dukej buzëqeshja e një vajze në klasë apo cingërima e ziles kur përfundonte ora e mësimet. Ndieja një gjendje të përzier bashkë me fantazi. Natyrisht, ky ishte iluzioni im më i bukur, kur bëhesha edhe komentues i këtyre situatave në mendjen time, se cili ishte dallimi midis parandjenjës dhe ndjenjës, parapëlqimit dhe pëlqimit, paragjykitimit dhe gjykitimit etj. Kur një nxënës i klasës mësonte më shumë se unë, assesi nuk e bindja vetveten: pse nuk bëhem unë si ai. Më kapte një inat i papërmbajtur. Isha i shqetësuar tepër për gjërat që nuk mund t'i bëja menjëherë, mirëpo çdo gjë dëshiroja të arrija me meritë. Isha ëndërrues melankolik dhe tepër i ndjeshëm. Shpeshherë mendoja që njerëzit dashakëqij të mos jetonin në këtë botë.

*Po nga jeta studentore, keni ndonjë ngjarje që e shihni në ëndërr edhe sot e tutje?*

Jeta studentore është dëshmia më e fuqishme personale për një lidhje me ngjarjet e jetës, ndoshta jetëshkrimi më i bukur për gjithë ato çaste e përjetime të rralla dhe të papërsëritshme.

Si student kam veshur kostume të bukura të cilat i qepja te rrobaqepësi. I ruaja dhe mbaja mirë dhe pastër. Gjithmonë gëzohesha kur blija kostum të ri. Kam pasur flokë të gjatë dhe jam shoqëruar shumë me studentë të brezit tim, por edhe të gjeneratave të tjera. Secili e kishim në vetvete vetëbesimin, vullnetin dhe krenarinë rinore, që të tregonim sa më shumë dije para profesorëve

tanë, por edhe t'i respektonim ata.

Kam shumë kujtime për t'i rrëfyer për ligjëratat, për jetën në konvikte studentore, për demonstratat e vitit 1981, për orët letrare të organizuara në Fakultetin Filozofik, për botimin e poezive në gazeta dhe revista letrare, por edhe për brengat e ndryshme.

Gjenerata e studentëve e Degës së Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, e viteve 1978-1982, së cilës i takoja edhe unë, ishte ndër gjeneratat më të mira asokohe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Cilën ngjarje do ta shihja në ëndërr sot e tutje? Kjo është pyetja juaj? Shumë ngjarje do të dëshiroja t'i kujtoja. Kjo është përgjigja ime.

Më pëlqente qëndrimi në mjedisin studentor, rrëfimi për situatat nga jeta reale, pasioni i vazhdueshëm për t'i njohur shëmbëlltyrat e poetëve të njohur të cilët në veprat e tyre e përshkruanin herë vetminë, herë dashurinë, herë vuajtjen. Kjo e fundit ma tërhiqte vëmendjen më së shumti. A thua edhe unë po kërkoja një të vërtetë të vetme. Nuk di pse më ngulitej vazhdimisht në mendje që të merrja sa më parë informacion për dukuritë dhe fenomenet letrare dhe për qëllimin e studimit të letërsisë. Ishte një testim i vetvetes. Nga të filloja më parë: nga teoria e letërsisë, nga kritika letrare apo nga historia e letërsisë apo të shkoja më tutje vetëm te problemet e filozofisë, përpara ambicieve të mia shpirtërore, se mos po bëja ndonjë mëkat të mendjes.

Gjithnjë ëndërrroja të zbuloja se cili ishte pushteti i poezisë? Cili do të ishte raporti i fjalëve dhe i figurave përbrenda një poezie? A do të ishin ato si fëmijëria apo rinia ime? A do të bëhem lexues, interpretues apo krijues i poezisë? A mund të mbaja në mendje mijëra kujtime dhe pastaj nga to ta gjeja të pamundurën, përmes fuqisë së përjetimit dhe përmasës së idealizmit, se cili do të ishte përkushtimi dhe fryti i dashurisë së madhe për letërsinë përtej joshjes magjike?

Kur vinte e shtuna më merrte malli për vendlindjen, sidomos për vëllanë, Muhametin dhe për motrën, Afërditën. Edhe fundjava kishte çaste të paharrueshme, meqë qëndrimi në mjedisin familjar ishte një kënaqësi e papërfytyrueshme.

Jeta studentore më bënte shumë ngulmues për ta mbërritur qëllimin për sukses në studime. Doja të dija çdo gjë për fatin tim, sikur përfytyroja një roman me imagjinatë të bujshme, me syzhe, fabul, personazhe të ndryshme, ku skicat e jetës sime do ta kishin mrekullinë e të shkruarit për diçka që do të mund të ekzistonte më vonë, fjala vjen, sikur *Interpretimi i ëndrrave* të Frojdit.

*(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Vijon në numrat e ardhshëm).*



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Vangjeli: Shpresoj që gjithë përvojën time t'ia përcjell Prishtinës

36-vjeçari është futbollisti më i ri i skuadrës së Prishtinës. Ai beson se gjithë përvojën ndërkombëtare do t'ia përcjellë kampiones së Kosovës. “Shpresoj që gjithë atë përvojë dhe forcën në karrierën time t'ia përcjell ekipit këtu, të ndihmoj në maksimum, qoftë për ta arritur kalimin e turneve në Evropë, qoftë për të arritur prapë objektivin kryesor të klubit, titullin e kampionit”, ka thënë Vangjeli

**PRISHTINË, 15 KORRIK (ER)** - Ish-reprezentuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Kristi Vangjeli, është futbollisti i ri i skuadrës së Prishtinës. Mbrojtësi shqiptar është paraqitur të enjten nga klubi “bardhekaltër”. Vangjeli ka premtuar se do të mundohet që të gjithë përvojën ndërkombëtare të sjellë në skuadrën më të madhe në Kosovë. “Jam shumë i lumtur që

do të jem pjesë e klubit më të madh në Kosovë. Ndiem mirë që do të vazhdoj ta vesh fanellën ‘bardhekaltër’. Kjo është një kënaqësi më tepër. Vijë në një ekip kampion dhe shpresoj që gjithë atë përvojë dhe forcën në karrierën time t'ia përcjell ekipit këtu, të ndihmoj në maksimum, qoftë për ta arritur kalimin e turneve në Evropë, qoftë për të arritur

prapë objektivin kryesor të klubit, titullin e kampionit”, ka thënë Vangjeli për faqen zyrtare të skuadrës së Prishtinës, i cili më pas ka bërë me dije se lojtarët nga Shqipëria që janë pjesë e Prishtinës kanë ndikuar që ai t'i thotë “po” ofertës së kampiones së Superligës. “Për ardhjen time kanë ndikuar edhe shokët që kam pasur në skuadra si Lilaj, Mici, Abazi e Muça,



duke këmbëngulur edhe klubi që të më ketë në radhët e veta, duke shprehur besim në mua, plus që është ekip që lufton gjithmonë për titullin e kampionit. Dhe kjo më obligon që të shtyj më shumë forcën time”, ka shtuar ai. Në fund, Vangjeli foli edhe për

moshën e tij: “Sa për moshën time, shpresoj të tregoj vetë fusha moshën time. Besoj se jam dhe ndihem ashtu sikur verëra sa më e vjetër aq më e mirë. Shpresoj këtë ta tregoj në fushë dhe mos t'ia lë asnjë tifoz apo analisti për të ma përmendur moshën time”. Futbollisti nga Korça ka lindur në vitin 1985 dhe është futbollisti i dalë nga academia e Aris Selanikut, pjesë e së cilës ishte nga viti 2003-2011 dhe 2013/14, Chernomorets Ukrainë 2011-2013, Skënderbeu Korçë 2014-2016 dhe 2016-2019, Astra Giurgiu Rumani 2016, Adelaide Australi 2019 dhe së fundi në KF Tirana 2019-2021.

## Çitaku: Ju po shënoni historinë, ju po bëni historinë. Jam krenare me ju

Prishtinë, 15 korrik - Kosova A për herë të parë do të garojë në një garë ndërkombëtare. Vashat e Kosovës do të debutojnë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Basketbollistet e Kosovës i ka vizituar edhe diplomatja e njohur Vlora Çitaku. Vlora Çitaku ka qenë ambasadore e Kosovës në ShBA, konsulle e përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ministre e Integritimit Evropian, ministre e Punëve të Jashtme dhe një nga gratë më të suksesshme shqiptare. Sekretarja e përgjithshme e Federatës e Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, e ka prezantuar Çitakun si një grua shumë të suksesshme,

shembull për vajzat dhe frymëzuese se si duhet të përfaqësohet vendi në arenën ndërkombëtare. “Prej vitit 2017, që jam pjesë e projekteve të Ambasadës Amerikane dhe Departamentit të Shtetit, sa herë kam kontaktuar me komunitetin e shqiptarëve në ShBA, më kanë lavdëruar ambasadorën Çitaku. Edhe në Departamentit të Shtetit kur jam takuar me amerikanë, më kanë treguar për Vlorën që ka bërë shumë për shqiptarët në ShBA. Jam ndier shumë mirë dhe krenare që ambasadorja po na përfaqëson në mënyrën më të mirë. Kur kemi bërë kampanjën për Përfaqësuesen A, për gratë që kanë influencë, më ka rënë



ndërmend Vlora dhe për këtë arsye kam dashur që ajo t'ju flasë ju për rëndësinë e përfaqësimit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare”, është shprehur Dushku para lojtareve dhe stafit të Kosovës A. Ndërkohë, Vlora Çitaku para vashave dardane ka mbajtur një fjalim shumë

domethënës. “Jam shumë e nderuar dhe e privilegjuar që jam këtu me ju. Gjatë punës sime si ambasadore, gëzimin më të madh e kam marrë nga ju. Nga vajzat dhe djemtë e ri të Kosovës. Nga pak përkrashje institucionale, ata kanë thyer shumë barriera. Ju do të shkoni në një vend (Qipro) ku unë nuk mund të shkoj si turistë e aq më pak si zyrtare e shtetit dhe ta përfaqësoj shtetin tim. Kjo nuk është hera e parë që sportistët e Kosovës ngrehin flamurin në një shtet që nuk e njih pavarësinë e Kosovës. Ju jeni ambasadorët më të mirë të vendit. Ju po jetësoni një ëndërr për të gjitha vajzat e reja të Kosovës të cilat do të rriten me ju

si inspirim. Unë e di se çfarë barre dhe përgjegjësie e madhe është të kesh flamurin mbi supe dhe ta përfaqësosh shtetin. Atë ditë kur dilni në fushën e basketbollit, duhet të dini që nuk jeni vetë, janë dy milionë zemra që do të jenë me ju. Ju vetëm jeni fitimtare, pasi jeni aty. Çdo sukses tjetër është i mirëseardhur. Ju jeni kampione për mua dhe vajzat e reja. Ju po shënoni historinë, ju po bëni historinë. Do të jemi krenarë me ju”, ka thënë Vlora Çitaku. Në fund, kapitenia e Kosovës, Arbnore Përçiku, i ka dhuruar një fanellë të Kosovës dhe një top të nënshkruar nga lojtarët. Kosova është në grup me Qipron dhe Luksemburgun.

## Istogu vazhdon bashkëpunimin me trajnerin Rama dhe tre futbollistë



**ISTOGU, 15 KORRIK** - Skuadra e Ligës së Parë, Istogu, ka rinovuar kontratat me trajnerin Nazmi Rama dhe futbollistët Valmir Hajrizaj, Egzon Kurteshi dhe Granit Ademaj. Trajneri Rama dhe futbollistët Hajrizaj, Kurteshi dhe Ademaj edhe për

një vit tjetër do të jenë pjesë e “Trofta”-ve. “Istogu me kënaqësi njofton të gjithë opinionin sportiv, dashamirët dhe tifozët e Istogut, që klubi ka përmbyllur me sukses marrëveshjen për bashkëpunim me trajnerin

Nazmi Rama edhe për një vit tjetër. Istogu njofton, po ashtu, se ka përmbyllur me sukses marrëveshjen për vazhdimin e bashkëpunimit me portierin Valmir Hajrizaj edhe për një vit tjetër. Istogu, gjithashtu, me sukses e ka mbyllur

marrëveshjen për vazhdimin e bashkëpunimit me futbollistin Egzon Kurteshi edhe për një vit tjetër. Granit Ademaj nënshkroi kontratën e re dhe kështu mbetet lojtar i Istogut edhe për edicionin 2021-2022”, thuhet njoftimin e skuadrës së Istogut.

## Ekipi i xhudos ‘aterron’ në Tokio

**TOKIO, 15 KORRIK** - Ekipi olimpik i xhudos ka mbërritur të enjten në aeroportin Heneda të Tokios. Ekipi u mirëprit nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së Kosovës në

Japoni, Arbër Mehmeti. Ekipi iu nënshtrua testit për Covid, me ç'rast të gjithë rezultuan negativë, siç kishin rezultuar negativë edhe në dy testet e bëra para nisjes në Qendrën

Laboratorike Olive në Prishtinë. Në emër të Komitetit Olimpik të Kosovës presidenti Ismet Krasniqi ka falënderuar Ambasadën e Kosovës në Japoni për pritjen dhe kujdesin

ndaj sportistëve të xhudos, të cilëve u uroi fat dhe mbarësi gjatë përgatitjeve në Komunën e Sanjos. Ekipi më 21 korrik transferohet në fshatin olimpik të sportistëve në Tokio.



## Gashi largohet nga KF Egnatia: Uroj të arrini majat e futbollit shqiptar

PRISHTINË, 15 KORRIK - Sulmuesi Dren Gashi edhe zyrtarisht është larguar nga KF Egnatia. Ish-futbollisti i shumë klubeve në Kosovë me skuadrën e Egnatiasë arriti që të inkuadrohet në

Superiore e Shqipërisë. “Dua t’ju njoftoj se nuk do të jem më pjesë e klubit më të ri në Superiore, KF Egnatia. ‘Luftën’ që e nisëm e arritëm së bashku me stafin presidencial, stafin

teknik, bashkëlojtarët, tifozët. Dua t’ju falënderoj gjithsecilit për respektin, emocionet dhe besimin maksimal që më keni dhënë gjatë gjithë kampionatit. Ju dëshiroj fat në Superiore dhe

të arrini majat e futbollit shqiptar apo edhe më tutje”, ka shkruar Gashi në profilin e vet në “Facebook”. Gashi nuk ka treguar se ku do ta vazhdojë karrierën futbollistike.



## Alexis Tolefree: E lumtur që po përfaqësoj Kosovën

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kosova A për herë të parë do të luajë në garat ndërkombëtare. Vashat dardane do të garojnë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro nga 20 deri më 25 korrik. Basketbollistja e vetme e natyralizuar te Kosova është Alexis Tolefree. “Jam e lumtur që jam pjesë e Kosovës dhe për herë të parë do të garojmë në arenën ndërkombëtare. Jam e lumtur që jam pjesë e kësaj gjenerate. Bashkëlojtarët dhe stafi më kanë pritur shumë. Me disa kemi luajtur së bashku dhe e njohim njëra-tjetrën”, ka thënë Tolefree për faqen zyrtare të FBK-së. Basketbollistja e cila mbron ngjyrat e Prishtinës ka folur për përgatitjet. “Deri më tani kanë shkuar mirë. Kemi zhvilluar edhe një ndeshje miqësore me Shqipërinë U20. Kemi edhe disa ditë përgatitje deri në fillimin e garave. Besoj se do të jemi gati”, shtoi tutje organizatorja



amerikane. Në fund ajo foli edhe për synimet. “Ne do të shkojmë ta japim maksimumin dhe shpresojmë në paraqitje dhe

rezultate pozitive”, ka nënvizuar Alexis Tolefree. Kosova është në grup me Qipron dhe Luksemburgun.

## Milwaukee barazon serinë finale ndaj Phoenixit

MILWAUKEE, 15 KORRIK - Milwaukee Bucks tregon dhëmbët edhe në përballjen e katërt të serisë së finaleve të NBA-s ndaj Phoenixit, duke lënë të kuptohet se deri në këto çaste parketi është një faktor decisiv në duelin mes tyre. Në “Fiserv Forum” në Wisconsin, Bucks triumfoi me rezultatin 109-103 duke barazuar në 2-2 serinë e finaleve dhe për ta përcaktuar skuadrën kampione të këtij edicioni në NBA do të luhen minimalisht gjashtë ndeshje. Davon Booker nuk mjaftoi për Phoenix Suns, edhe pse skuadra nga Arizona e nisi shumë mirë ndeshjen duke e mbyllur periodën e parë me një rezultat parcial 23-20 në favor. Por falë lojës së shkëlqyer të dyshes Giannis Antetokounmpo - Kris Middleton, Milwaukee ishte më i mirë në periodën e dytë me dy skuadrat që shkuan në pushim në baraspeshë të plotë. Perioda e tretë foli më shumë për Phoenixin që, i frymëzuar edhe nga paraqitja fantastike e Bookerit, autor i 42 pikëve në total, në këtë duel arriti



të shënonte 6 pikë më shumë në këtë 12-minutësh duke krijuar përshtypjen se në këtë sfidë të 4-t do të buzëqeshte skuadra e trajnerit Monty Williams. Por në periodën e 4-t dhe atë të fundit të lojës, Milwaukee, i mbështetur fuqishëm edhe nga 16 911 spektatorët në Fiserv Forum, arriti të përmbyste plot 9 pikë disavantazh duke marrë një fitore

të madhe me shifrat 109-103 që barazoi në 2-2 serinë e finaleve të mëdha të NBA-s ndaj Phoenixit. Kris Middleton realizoi 40 pikë në këtë përballje për vendasit, ndërkohë që greku Antetokounmpo spikati me 26 pikë, 14 rebounde dhe 8 asistime. Tashmë seria e finaleve do të zhvendoset në Arizona për ndeshjen e pestë.

### SHKURT

#### Di Marzio: Ujkani do të transferohet tek Alessandria

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Samir Ujkani, është afër të largohet nga Torino. Sipas “Gianlucadimarzio.com”, Ujkani do ta vazhdojë karrierën me skuadrën e sapopromovuar në Serinë B, Alessandria. Ujkani është objektivi i Alessandrias për portën dhe mund të arrijë me parametër zero pasi kontrata e tij me Torinon ka skaduar në qershor dhe ende nuk ka rinovuar. Së fundmi nga Torino është gati të largohet edhe Salvatore Sirigu dhe kjo nuk dihet sesi do të ndikojë në largimin e Ujkanit nga skuadra.

#### Robbeni tërhiqet përfundimisht nga futbollit

Ish-ylli i Bayern Munchenit dhe Chelseat, Arjen Robben, ka njoftuar tërheqjen nga futbollit profesionist në moshën 37-vjeçare. Holandezi ka konfirmuar lajmin në një deklaratë përmes faqes zyrtare të Groningenit në të cilën shkruhet: “Të dashur miq futbollit, unë kam vendosur ta ndaloj karrierën time aktive në futboll. Një zgjedhje shumë e vështirë. Unë dua t’i falënderoj të gjithë për mbështetjen e ngrohtë”. Robben largohet me një karrierë të lavdishme, veçanërisht te Bayerni ku zhvilloi 201 ndeshje në 10 vjet.

#### City interesohet për Lewandowskin

Ekipi i Manchester Cityt është duke shfaqur interes jashtëzakonisht serioz për sulmuesin e ekipit të Bayern Munchenit, Robert Lewandowski. I gjithë ky interesim erdhi pas dështimit për Harry Kane nga Tottenham Hotspuri. Lewandowski është një prej golashënuesve më të suksesshëm në Evropë sezonet e fundit. Sulmuesit polak i kanë mbetur edhe dy vjet nga kontrata me Bayernin, por ende nuk e ka rinovuar marrëveshjen e tij dhe nuk dihet se a do ta vazhdojë këtë kontratë edhe në të ardhmen. “Daily Mail” Sport raporton se ekipi i Manchester Cityt është duke e monitoruar situatën e Lewandowskit me qëllim që “t’i bëjnë ftesë për t’iu bashkangjitur atyre”.

#### Griezmanni mund të rikthehet tek Atletico Madridi

Antoine Griezmann është i tepërt te Barcelona dhe e ka kuptuar që nuk ka më vend për të qëndruar në këtë skuadër. Ai do të sakrifkohet për ta nënshkruar kontratën e Leo Messit në La Liga. Për Grizmannin ka pasur interesim nga shumë skuadra, por duket se qëllimi dhe dëshira e tij lidhet me një rikthim të mundshëm tek Atletico Madrid. Ai ka nisur pushimet me Koken dhe ky i fundit mund të futet “mik” për ta rikthyer në skuadrën ku kaloi vitet e arta si futbollist. Asgjë nuk është e lehtë, por nisur nga dëshira e lojtarit dhe e klubit për ta prishur bashkëpunimin. Diego Simeone gjithashtu do të ishte i lumtur që ta përqafoje sërish “luftëtarin” e tij, por kjo varet shumë nga aspekti ekonomik. Griezmanni konsiderohet si një dështim te Barcelona dhe nuk arriti të bënte atë për të cilën u transferua.

## Matthaus: Anglezët e meritonin traumën nga humbja me penallti

Lothar Matheus ka folur për finalen e humbur nga Anglia me penallti kundër Italisë. Ish-kampioni gjerman, gjithmonë shumë i ashpër kur flitet për

Anglinë, edhe këtë herë është i drejtpërdrejtë në arsyetimin e tij. “Tifozët anglezë ishin armiqësorë me atë vajzën e trishtuar ne fanellën e

Gjermanisë. Portierin e Danimarkës, Kasper Schmeichel, e shënjestruan me laser gjatë goditjes së një penalltie që Raheem Sterling e fitoi duke u

hedhur. Të gjitha këtyre u shtohen edhe sjelljet raciste në drejtim të lojtarëve të tyre pas finales. Të dashur anglezë, ishte një sjellje antisportive që nuk

duam ta shohim më. Më vjen keq për lojtarët, por anglezët e meritojnë traumën pas finales së humbur me penallti”, ka deklaruar Matthaus.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

